

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MCGEE GROUP” SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “MCGEE GROUP” Sh.p.k.

1- ESTHER MARY MCGEE atesia **DANIEL PETER** , shtetase ANGLEZE , lindur me 07.01.1979 ne DURHAM, identifikohet nepermjet pasaportes 525397836.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “MCGEE GROUP” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise “MCGEE GROUP” Sh.p.k.,

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “ADRIA” Lagja nr. 4,Godina me xhama ,afer karburant ALPET ,kati i 3 ,Zyra 05,Nr. Pronesie 6/62,zona kadestrale 8514, Dures, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

AKT THEMELIMI “MCGEE GROUP”

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "MCGEE GROUP" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie e cila ka si objektiv :

Keshillime ne fushen e investimeve te huaja, marketing.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndarë në 1 pjesë .Kapitali themeltar i shoqërisë zoterohet nga:

1. ESTHER MARY MCGEE	100,00%	100.000,00 LEKE
-----------------------------	----------------	------------------------

Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i

2

AKT THEMELIMI "MCGEE GROUP"

ESTHER MARY MCGEE

tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shumë se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërisë “**MCGEE GROUP**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezagjatja dhe kompetencat e tyre. Administratorët e shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare janë emeruar:

- 1. ESTHER MARY MCGEE**
- 2. MIMOZA MURATI**

Te cilet mund te ushtrojne kompetencat e tyre se bashku ,ose edhe vec e vec .

NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.


Tirane 26/07/2021

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE “MCGEE GROUP” SH.P.K.

ESTHER MARY MCGEE

3

AKT THEMELIMI “MCGEE GROUP”



ESTHER MARY MCGEE

Esther Mary McGee

AKT THEMELIMI "MCGEE GROUP"